



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 65.2, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 09.09.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. EMRAH ISMAIL** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Kosova Demokratik Turk Partisi- KDTP" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Renan Imami.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Emrah Ismaili dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 07.09.2019, Nr.950/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit komunal z. Renan Imami pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të punësimit të tij në shërbimin civil në pozitën e zyrtarit për komunitete.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z. Emrah Ismail nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 09.09.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

